

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale të pandehurit D. P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1847-7/2017 të datës 30.08.2017, me kërkesë për dhëniën e urdhrin ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor me datë 11.10.2017, morri këtë:

**AKTGJYKIM**

**I pandehuri:**

D. P. nga i ati E. dhe e ëma N. e lindur I., i lindur me datë " " nr., ka të kryer shkollën e mesme, pa punë, i pa martuar, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**ËSHTË FAJTOR**

Ditën kritike me datë 22.06.2017 rreth orës 23:10 minuta, në Prizren rrugën " " nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacion rrugor, ka drejtuar automjetin e markës "VW GOLF" me targa të regjistrimit " " dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 120 të LSKRR, në atë mënyrë që nuk ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë, deri sa lëvizte në drejtimin e rrugës për transit të vjetër, i njëjti lëvizë në shiritin e majtë që i dedikohet rrugës për transit të vjetër dhe në momentin kurrë arrin në afërsi të pompës së benzinës "Petrol Compani", pa u sigurua fare dhe në mënyrë jo të rregullt, nga shiriti i majtë merr veprimin për të futur në pompën e benzinës në anën e djathtë dhe kur kalon në shiritin e djathtë të rrugës në drejtimin Suharekë – Prizren, në pjesën e parme të automjetit e godet automjetin e markës "VW Polo" me targa të regjistrimit " " e godet në anën e majtë anësore, të cilën po e drejtonte i dëmtuari A. U. ku si pasojë e këtij aksidenti, pos dëmeve materiale në automjete, lëndime trupore pësojnë: M. U. dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të qafës dhe regjionit i jor (lumbal), ndërsa I. U. pëson ndrydhje të indeve të buta të regjionit të qafës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

**Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.**

Në kuptim të dispozitës së nenit 495 të KPPK i jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

Pranohet kërkesa e prokurorit të shtetit në Prizren nën numër PP/II.nr.1847-7/2017 të datës 30.08.2017.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 41, 46 lidhur me nenin 43 par.1 nën par.1.3, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK si dhe nenit 365 par.1 të KPPK i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 € (dyqind euro) e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 10 (dhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

Të dëmtuarit A. U. , M. U. dhe L. U. që të gjithë nga fshati K. Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të shpenzimeve të ekspertit të komunikacionit për ekspertizë shumen prej 40.88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 50 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1847-7/2017 të datës 30.08.2017 kundër të pandehurit D. P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, me ç'rast ka parashtruar edhe kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me propozim që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës të jepet urdhri ndëshkimor dhe të shqiptohet dënimi me gjobë.

Pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorit të shtetit në Prizren në bazë të provave të propozuara të bashkangjitur në shkresat e lëndës dhe atë: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Inxhinier S. Sh. të datës 16.08.2017, ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. F. D. të datës 21.08.2017, raporti i qendrës emergjente në Prizren me numër protokollit 6462, 6460, 6461 të datës 23.06.2017, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës të cilat janë paraqitur në aktakuzë. Nga të gjitha këto prova është vërtetuar se i pandehuri Dardan Ponxhaj, gjatë drejtimit të automjetit të markës “VW Golf” me targa të regjistrimit nga pakujdesia ka ra në kundërshtim me nenin 120 të LSKRR, nuk i ka përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë, deri sa lëvizte në drejtimin e rrugës “Ukë Bytgyçi”, në drejtim të rrugës për transit të vjetër, i njëjti lëvizë në shiritin e majtë që i dedikohet rrugës për transit të vjetër dhe në momentin kurrë arrin në afërsi të pompës së benzinës “Petrol Compani”, pa u sigurua fare dhe në mënyrë jo të rregullt, nga shiriti i majtë merr veprimin për të futur në pompën e benzinës në anën e djathtë dhe kur kalon në shiritin e djathtë të rrugës në drejtimin Suharekë – Prizren, në pjesën e përparme të automjetit e godet automjetin e markës “VW Polo” me targa të regjistrimit dhe e godet në anën e majtë anësore, të cilën po e drejtonte i dëmtuari A. U. , ku si pasojë e këtij aksidenti, pos dëmeve materiale në automjete lëndime trupore pësojnë: M. U. dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të qafës dhe regionit i dorës

(lumbal), ndërsa L. U. pëson ndrydhje të indeve të buta të regjionit të qafës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Andaj gjykata ka aprovuar kërkesën e prokurorit të shtetit në Prizren dhe ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi në bazë të provave të besueshme të lartshënuara.

Vendimi mbi udhëzimin të dëmtuarave në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1747/2017 të datës 11.10.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**  


**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim kësaj gjykate në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes.

EXP. 5  
2 Fletë/zyerë  
1 Fletë/akt  

---

11.10.17

